

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO/ "Pendohem që qëllova me shishe", Delina Fico rrëfen incidentin me protestuesit: Na shanin prej 5 minutash
ADRESA	https://kohajone.com/aktualitet/video-pendohem-qe-qellova-me-shishe-delina-fico-rrefen-i-incidentin-me-protestuesit-na-shanin-prej-5-minutash/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 12:18:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 12:08:58 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dfd9be973af217e6c41307e7aa0a6dd744f88495bf61b8d0398168dd9d112723
TEKSTI	fa966fdd40bb6f63cda346bae01626b68ccddd50959ff0be2c9ade0c54e6d27d
PAMJA	0b970a29d091c13d14a3b3e8f726b63ae653d010e9c2e768a2adbce17ac49ea5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a4d20b1df6baf0d97cadce8b9310f113218d33c8ff32b42ba205b5e63676a280
E MËPARSHMJA	73f25f345a75779901f76ca03cde83395c1ecea0d5c6d8c3e91d30471cdec21f
RRËNJA MERKLE	7ef11613d0a46fe814f564609ee7439753917635a3984a70b661e478103337ad
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a4d20b1df6baf0d97cadce8b9310f113218d33c8ff32b42ba205b5e63676a280>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

VIDEO/ "Pendothem që qëllova me shishe", Delina Fico rrëfen incidentin me protestuesit: Na shanin prej 5 minutash

AKTUALITET E PRENTE, 25 SHTATOR 2026 14:08



Deputeti i PS-së, Bledi Çuçi mbremjen e së enjtes ishte duke darkuar në një restorant në zonën e "Pazari i Ri", kur u përball me thirrjet: "Burg, hajdut", nga protestuesit. Ajo që reagoi është bashkëshortja e tij, Delina Fico, edhe duke qëlluar me shishe uji në drejtim të protestuesve. Fico një lidhje të drejtpërdrejtë me emisionin "Shqipëria Live", tregon se çfarë ndodhi. Ajo u shpreh se nuk u përmbajti dot dhe u irritua kur protestuesit nisën të përmendnin atë. Sipas saj, protestuesit kishin 5 minuta që shanin para se ajo të bënte atë reagim. Kur ajo mori shishen e ujit për t'a hedhur në drejtim të tyre, ata hapen kamerat menjëherë.

Pjesë nga intervista:

Delina Fico: Ne ishim në një lokal me miqtë. Ishin disa të rinj që nxorën kamerat dhe thonin 'hajdut'. E më pas shtuan dhe gruan e aty u irritova. Nuk u përmbajta dhe i gjuajta me shishen e ujit. Bledi dhe miqtë më thanë mos i konsidero se atë vëmendje duan. Një ngjarje e trishtuar. Grupi ishte rreth moshës 20 vjeç. Ju drejtova më shumë vajzave që ishin aty dhe do kisha dëshirë ti takoja e të flisja me to, është një qëndrim i gabuar. Më lënduese ishte që grupi i të rinjve rrinte djathtas, ndërsa një burrë më i madh rrinte në të majtë dhe i dirigjonte, vetë fshihej si skuth. Gabim ata dhe gabim ndoshta unë që reagoja ashtu. Ata vajza e djem nuk dinë për punën time, as për punën e partnerit tim. Është një tjetër gjë të kritikosh e të protestosh.

Sidorela Gjoni: A është e gjithë ngjarja ajo që pasqyrohet në video?

LAJMET KRYESORE



Zgjedhjet lokale në 2027, KQZ kërkon rreth 300 punonjës shtesë



David Beckham merr 39 milionë paund dividend, marrëveshjet e Kupës së Botës nxisin fitime rekord



Po mbërrin në Tiranë ambasadori i ri amerikan, Eric Wendt



Kryeministri Rama në OKB, New York



Erion Malaj, një fytyrë e re që i duhet Partisë Socialiste

TË PËRZGJEDHURA



David Beckham merr 39 milionë paund dividend, marrëveshjet e Kupës së Botës nxisin fitime rekord



Ish-ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu te Nikoll Lesi: Nuk ka ministra hijet Balluku-lokomotivë shtetfo...



Sukses i menjëhershëm për Muse të Metës: Mjeti i AI tejkalon rivalët si ChatGPT dhe Claude



Inteligjenca artificiale mund të jetë më e rrezikshme se bomba atomike. Robotët e vitëve 2030, 2040, 2...



Hamilton mohan kategorikisht: "S'kam kërkuar ndryshime stafi te Ferrari"

MË TË LEXUARAT

Delina Fico: Kishin 5 minuta që shanin para se unë të reagoja, kur ata e tepruan, sidomos kur më përfshinë mua. Unë bashkëjetoj me Bledi Çuçin, po nuk merrem me politikë. Ata kanë transmetuar vetëm momentin kur kam hedhur shishen e ujit.

Sidorela Gjoni: Çfarë mendon tani që sheh atë video?

Delina Fico: Më vjen shumë keq, jam e trishtuar. Pse disa të rinj i lejojnë vetes të të ofendojnë. Kanë problemet e tyre, të dalin në protestë. Unë mendoj se bëra gabim që qëllova me shishe por ndihem e fyer thellë. Nuk është hera e parë që ndodh një gjë e tillë. Kam 40 vjet punë mbi shpatulla e le të më gjykojnë për çfarë kam bërë në jetë. Thonin Bledi Çuçi dhe gruaja hajdut, në burg. Përsëritet disa herë fjala grua dhe aty reagoja. Është tepruar shumë. E di ca ishte më fyese? Fakti që hapën kamerat menjëherë, nuk ë bëjnë se ju vjen nga zemra, por e bëjnë për të të filmuar sipas skenarit, të dalin në media dhe që menaxhohen nga burri që ishte aty. Manipulim i situatës.

Sidorela Gjoni: Çfarë komunikuat me zotin Çuçi?

Delina Fico: Këto që po të them ty. Pse ka ardhur puna kështu? Pse nuk jemi qytetarë që ta shprehim zemërimin tonë aty ku duhet? Jemi të gjithë qytetarë të këtij vendi. Ke pakënaqësi ndaj shtetit, dli në protestë. Janë metoda fashiste, duan të mbjellin pasiguri në vend. Ata mund të vinin të flisnin me mua dhe të më thonin jemi shumë të pakënaqur. I kemi të gjithë instrumentet të bëjmë grevë, protestë, duhet të marrë fund urrejtja. Kjo urrejtja e madhe për njerëzit e zgjedhur tani është vulgare, nuk të çon askund. Janë të manipuluar nga ai që ishte aty për të nxitur konflikte sociale.

Sidorela Gjoni: Përtej incidentit, cili është mendimi juaj personal për protestën?


Delina Fico: Protestat paqësore kanë mbështetjen time që nga dita e parë. Kam shoqëri dhe kushërinj që dalin në protestë, është e drejta e tyre. Ka patur njerëz që më kanë mbështetur, edhe ata që dalin në protestë sepse duan qytetari. Dhuna sjell dhunë. Konfliktet zgjidhen me institucionet.

Sidorela Gjoni: A mendoni që një person që është i zgjedhur me votë nga njerëzit duhet të kishte një reagim tjetër?

Delina Fico: Bledi është politikan, jo se është partneri im, është një nga figurat politike më me integritet. Nuk është hera e parë që i ndodh, nuk e meriton sulmin në kohën e tij të lirë kur është me familjen. Siç nuk dua që Bledi të flasë në emrin tim, as unë nuk mund të flas në emrin e tij.

Sidorela Gjoni: A ju vjen keq që iu linçojnë?

Delina Fico: Shumë keq më vjen, e kam thënë disa herë, jam një grua, bashkëjetoj me Bledin, kam punën time. Jam kundër dhunës ndaj çdo politikani, gazetari apo aktivisti. Është vije e kuqe në jetën time dhuna.



MË SHUMË NGA AKTUALITETI



Zgjedhjet lokale në 2027, KQZ kërkon rreth 300 punonjës shtesë



VIDEO/ Goditi shefin e komisaritit, por nuk pati denoncim. Zbardhet ...



Anulohet tenderi për shërbimin e hemodializës në 5 qytete



Deputetja socialiste i del në mbrojtje Klodiana Lalës: SPAK ta trajto...



INSTAT: 9,4 milionë të huaj hynë në Shqipëri në 8 muaj, rritje me 5,3%



I shpëton burgut ish-drejtoresha e Postës Durrës, gjykata e lë në "ar...

LAJMET E FUNDIT



Zgjedhjet lokale në 2027, KQZ kërkon rreth 300 punonjës shtesë

[6 MINUTA MË PARË](#)



Debate për Vlora Hysenin në Komision, deputeti Erion Malaj: Përgjegjësia penale është individuale

[9 MINUTA MË PARË](#)



VIDEO/ Goditi shefin e komisaritit, por nuk pati denoncim. Zbardhet çfarë ndodhi në Durrës

[17 MINUTA MË PARË](#)



Ministri Demo takon ambasadorin e Holandës, në fokus lufta kundër krimit të organizuar

[29 MINUTA MË PARË](#)

VIDEO/ "Pendothem që qëllova me shishe", Delina Fico rrëfen incidentin me protestuesit: Na shanin prej 5 m...

[39 MINUTA MË PARË](#)

Bayern tenton afrimin e Dani Olmo, Barcelona kërkon rreth 70 milionë euro

[45 MINUTA MË PARË](#)

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

KOHA JONË

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frashëri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA



Ekonomi

TEKNOLOGJI

KULTURA

NIPT: J71425013C

EDITORIAL

SHOWBIZ

HISTORIKU

WEBTV

SHËNDETI

KONTAKT

AKTUALITET

© 2024 KOHA JONE. All rights reserved.

PRIVACY POLICY

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.